



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. 2217 Prot. 12

Vlorë më, 08.10 2024

VENDIM
Nr. 43 datë 08.10.2024
PËR

**PËR NUMRIN MINIMAL TË STUDENTËVE PËR AKTIVIZIMIN E
PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË DHE PROGRAMET QË QË
NUK DO TË AKTIVIZOHEN PËR VITIN AKADEMIK 2024-2025 NË
UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI", VLORË**

Në mbështetje, të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 3, neni 35, pika 1, gërma "dh", neni 19, pika 1, gërma f, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë Udhëzimit nr.1 të MAS datë 14.01.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e IAL-ve, degëve dhe njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e IAL-ve", KREU IV, gërma "C", VKM 448, prot, datë, 03.07.2024, "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin 386, datë 01.06.2022, "Për miratimin e fushave dhe programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer e të studentëve që ndjekin këto programe në institucionet publike të arsimit të lartë", të ndryshuar, Senati Akademik në mbledhjen e datës, 08.10.2024,

VENDOSI:

1. Numri minimal i studentëve të regjistruar që mundësojnë aktivizimin e një programi studimi për ciklin e parë të studimit në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë, të cilët nuk janë prioritet kombëtar dhe nuk janë pjesë e fushave dhe programeve të VKM Nr.488, datë 03.07.2024 do të jetë 5 (pesë)
2. Numri minimal i studentëve të regjistruar që mundësojnë aktivizimin e një programi studimi të ciklit të parë të studimit në UV, të cilët janë prioritet kombëtar dhe janë pjesë e fushave dhe programeve të VKM Nr. 488, datë 03.07.2024, do të jetë 3 (tre).
3. Ky vendim ka fuqi vepruese vetëm për vitin akademik 2024-2025.
4. Për vitin akademik 2024-2025 nuk do të aktivizohen programet e studimit të ciklit të parë të studimit si më poshtë:
 - a) Matematikë-Fizikë (FSHTN)
 - b) Gjuhë Italiane (FSHH)
 - c) Gjuhësi e Aplikuar në Fushën e Turizmit (FSHH)
5. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi të gjitha strukturat akademike, ndihmësakademike e administrative si dhe autoritetet drejtuese të të gjitha niveleve. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Aurela Sallaj